



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:116777

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06573914

K.DH.SH.II.nr.843/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Restaurant Pizzeria Verona” me nr. Biznesi 70098834, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial, ndaj debitorit “Trepça” sh.,a, me NUI 81128747, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1347/23 dt.27.12.2023, me datën 10.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “Restaurant Pizzeria Verona” me nr. Biznesi 70098834, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1347/23 dt.27.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1347/23 dt.27.12.2023, ne pjesën e I te dispozitivit ka aprovuar si pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” sh.,a, me NUI 81128747, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial dhe urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.833/23 dt.18.07.2023 te Përmbaruesit Privat Atip Mustafa shfuqizohet për shumën prej 66,118.32, ndërsa ne pjesën II te dispozitivit e ka refuzuar si pjesërisht te pabazuar prapësimin e debitorit “Trepça” sh.a, me NUI 81128747, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial, ashtu që ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.833/23 dt.18.07.2023 te Përmbaruesit Privat Atip Mustafa për shumën e detyrimit prej 146,278.46 euro se bashku me kamatën ligjore prej 8%.

Kundër këtij aktvendimit, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës te LPK dhe LPP, vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta miratojë te bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimi i atakuar te ndryshohet dhe urdhri përmbarimor te mbetet ne fuqi ndërsa debitori te detyrohet te paguaj shpenzimet për përpilim te ankesës ne shumën prej 416 euro.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Restaurant Pizzeria Verona” me nr. Biznesi 70098834, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial , me datë 17.07.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Trepça” sh.,a, me NUI 81128747, me seli ne Mitrovicë Parku Industrial, në bazë të dokumentit te besueshëm- Faturave nr.35/21 dt.04.09.2021, 42/212 dt.04.10.2021, 43/21 dt.03.11.2021, 50/21 dt.01.12.2021, 55/21 dt.31.12.2021, 05/22 dt.06.01.2022, 01/22 dt.03.01.2022, 08/22 dt.04.02.2022, 09/22 dt.04.02.2022, 10/22 dt.04.03.2022, 18/22 dt.05.04.2022, 01/23 dt.05.01.2023. Përmbartuesi Privati Atip Mustafa, Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit për Përmbartim nga ana e kreditorit, ka nxjerr urdhrin P.nr.833/23 dt.18.07.2023, me te cilin ka obliguar debitorin qe ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te urdhrin përmbartimor, ne emër te borxhit nga faturat, kreditorit ti paguaj shumen prej 212,396.78 euro, me kamatë ligjore prej 8% ne vit sipas LMD si dhe ti paguaj dhe shpenzimeve te procedurës.

Ndaj këtij urdhri, me dt.01.08.2023, prapësim ka paraqitur debitori, me arsyetimin se dokumentet mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi nuk janë te përmbartueshme dhe nuk janë te përshtatshme për ekzekutim, sepse këto fatura nuk kane te përcaktuar kohen e përmbartjes se detyrimit siç parashihet me nenin 27 te LPP, i referohet edhe nenit 341 par.1.2 te LMD si dhe nenit 353 par.1 te LMD, andaj propozon qe gjykata ta anuloj urdhrin përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datën 11.08.2023, me arsyetimin se pretendimet e debitorit ne prapësim nuk qëndrojnë sepse faturat kane kohen e përmbartjes se detyrimit, sqaron se nuk kemi te bëjmë me parashkrim ashtu siç pretendon debitori sepse ne rastin konkret kemi te bëjmë me raporte afariste për te cilat parashihet afati 3 vjeçar me ligj, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si te pambështetur ne prova.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë, pas prapësimin te debitorit dhe përgjigjes ne prapësim, ka marrë aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1347/23 dt.27.12.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të bazuar dhe ka lenë ne fuqi pjesërisht urdhrin përmbartimor, ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lenë pjesërisht urdhrin përmbartimor ne fuqi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të njëjtit. Gjykata ne vendimin e saj vlerëson se faturat nr.42/21 dt.04.10.2021 dhe nr.35/21 dt.04.09.2021, ne baze te cilave është lejuar përmbartimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 i LPP, sepse propozimit për përmbartim i janë bashkangjitur ne kopje, pra ne lende nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me këto dispozita, andaj mbi këtë bazë gjykata referuar nenit 43 par.4 e LPP shfuqizon pjesërisht urdhrin përmbartimor me arsyetimin se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ashtu qe propozimi për përmbartim konsiderohet se përmban te meta nga neni 38 par.1 te LPP te cilat ne këtë faze te procedurës nuk mund te evitohen nga gjykata bazuar ne kufizimin e gjykatës vetëm ne shqyrtim te përshtatshmërisë se dokumentit mbi bazën ete cilit është lejuar përmbartimi. Gjykata po ashtu gjen se faturat tjera mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 te LPP sepse këto fatura kane tiparet e një dokumenti te besueshëm sepse ne to janë dhënë te dhëna te mjaftueshme për palët dhe për mallrat, është përcaktuar shuma

e detyrimit dhe koha e përmbushjes, te njëjtat janë bashkangjitur propozimit për përmbarim ne origjinal, janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga i njëjti duke vendos si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se faturat nr.42/21 dt.04.10.2021 dhe nr.35/21 dt.04.09.2021, ne baze te cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 37 i LPP, sepse propozimit për përmbarim i janë bashkangjitur ne kopje dhe jo ne origjinali apo kopje te vërtetuar ashtu siç kërkohet me këtë dispozitë, andaj kjo gjykatë pranon përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë e cila sipas dispozitivit dhe vlerëson nenin 43 par.4 e LPP. Po ashtu kjo gjykate vlerëson përfundimin juridik te gjykatës e shkalles e parë se faturat nr. 43/21 dt.03.11.2021, 50/21 dt.01.12.2021, 55/21 dt.31.12.2021, 05/22 dt.06.01.2022, 01/22 dt.03.01.2022, 08/22 dt.04.02.2022, 09/22 dt.04.02.2022, 10/22 dt.04.03.2022, 18/22 dt.05.04.2022, 01/23 dt.05.01.2023 mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi, i plotësojnë kushtet për te qenë dokumente te besueshme konform nenit 29 par.3 te LPP i cili parasheh qe se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”, sepse ne rastin konkret këto fatura janë te nënshkruara ose edhe vulosura nga debitori ashtu qe edhe konsiderohet se janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti, përmbajnë te gjitha te dhënat për palët ne procedure si dhe elementet tjera te kërkuara me dispozita ligjore, andaj si te tilla plotësojnë kushtet ligjore për tu ekzekutuar, pasi janë ne pajtim edhe me nenit 37 te LPP i cili përcakton se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, sepse faturat janë bashkangjitur ne origjinal propozimit për përmbarim.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK dhe e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike nga neni 183 i LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kjo gjykatë ka analizuar provat e ofruara me ankesë nga kreditori përkatësisht faturat nr.42/21 dt.04.10.2021 dhe nr.35/21 dt.04.09.2021. Lidhur me provat e reja gjykata i referohet Nenit 180 par.1 te LPK i cili parasheh qe “*Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë*”. Andaj, duke shqyrtuar pretendimin e kreditorit me ankesë me çka ka parashtruar prova të

reja, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se referuar dispozitës së Nenit 180 par.1 të LPK – së, kjo gjykatë si gjykatë e shkallës së dytë nuk mund të pranojë provat e propozuara me ankesë për të vërtetuar faktet e çështjes, ngase vlerëson se kreditori provat – faturat origjinale i ka disponuar dhe paraqitja e tyre në këtë fazë nuk i jep mundësinë debitorit që të njëjtat t'i kundërshtojë. Në një gjendje të tillë të çështjes kjo Gjykatë vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka qenë i drejtë dhe ka vlerësuar drejtë faktet e çështjes, andaj lëshimet e kreditorit për mos paraqitjen me kohë të provave nuk mund të eliminohet në këtë fazë të ankimit.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.843/24, me datë 10.12.2024

Gjyqtari
Dren Rogova